



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) lidhur me nenin 17, pikat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 41, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në bazë të vendimit të Kuvendit 64/21 me datë 25.03.2021, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, merr vendim dhe shpallë:

#### THIRRJE PUBLIKE

- **Për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500.00€, nga fusha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kriteret më poshtë:**

1. Për të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i cili është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Vushtrrisë, të aplikojnë për mbështetje financiare:
2. Personat juridik - OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

##### Kulturë:

- Manifestime; (shënimi i datave me rendësi historike, festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe datave tjera me rendësi për komunën e Vushtrrisë)
- Teatër; ( prodhimi i shfaqjes dhe promovimi i tyre)
- Muzikë;( kompozimi i veprës se re dhe fuqizimi i muzikanteve te rijnë)
- Arte vizuele; ( fuqizimi i veprës se re dhe organizimi i ekspozitës ne hapësira publike)
- Tradicionale, përmes të cilave do të promovohen vlerat kulturore;
- Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve të tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin, zhvillimin dhe rritjen e pjesëmarrjes në programet kulturore;
- Zhvillimi i turizmit kulturor;
- Aktivitete letrare; (orë letrare, tribuna letrare)
- Projektet lidhur me hartimin e politikave / programeve dhe dokumenteve lokale me qëllim të zhvillimit të kulturës dhe bashkëpunimin e shoqërisë civile me institucionet lokale në veçanti te kulturës.

##### Rini:

- Konferenca, Forume, Seminare, Trajnime, Punëtori, Debate, Hulumtime, për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve rinore dhe luftimin e dukurive negative tek të rinjtë;
- Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve;
- Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i organizatave rinore;

- Mbështetja e aktiviteteve rinore, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, mbështetja e ideve-projekteve si dhe promovimi i talentëve;
- Konsolidimi dhe promovimi i legjislacionit për rininë sidomos ai lokal;
- Mbështetja për përfshirjen sociale dhe organizimi i ngjarjeve promovuese dhe tradicionale rinore;
- Aktivitete, mobilizimi që ndërlidhen me aktivizëm të rinisë aktive në kohën e pandemisë ( COVID 19);

**Sport:**

- Aktivitetet sportive; ( klube dhe shoqata sportive )
- Pjesëmarrja e klubeve sportive në gara kampionale dhe për kupën e Republikës të organizuar nga Federatat përkatëse;
- Pjesëmarrja nëpër turne të ndryshme në vend dhe regjion;
- Organizimi i turneve me rastin e festave shtetërore dhe kombëtare;
- Edukimi i të rinjve përmes sportit (projekte edukative për grup-mosha të reja);
- Organizimi i turneve me rastin e shënimit të datave përkujtimore.

3. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision 5-anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim, sipas rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe rregullores NR.144/18 të Komunes së Vushtrrisë , mbi ndarjen e subvencioneve.

Kriteret vlerësuese shtesë janë: raporti paraprak narrativ dhe financiar, për projektin paraprak.

4. Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programin (e shtypur dhe CD );
2. Formulari i propozim buxhetit ( e shtypur dhe CD)
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur);
4. Formulari i deklaratës se partneritetit (e shtypur nëse ka me shume se dy OJQ)
5. Formulari i deklaratës se projekteve te financuara (e shtypur)
6. Kopja e certifikatës se regjistrimit OJQ –se;
7. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
8. Vërtetimi që OJQ, nuk ka obligime ndaj ATK-së
9. Kopja e konfirmimit nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;
10. Kopja e dokumentit identifikues të personit te autorizuar te OJQ-se;
11. Dëshmi që ka dorëzuar raportin financiar dhe narrativ nga viti paraprak (vetëm për përfituesit për vitin 2020);

5. Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve është 15 dite pune dhe përfundon me datën 07.05.2021

6. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare: 70.000 Euro

7. Personat juridik - OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike. Periudha e zbatimit të projektit është deri në muajin dhjetor 2021

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë Personat juridik - OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, së paku një vitë para publikimit të Thirrjes Publike, të cilat aplikojnë me projekt/programme me interes për Komunën e Vushtrrisë.

Personat juridik - OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Para nënshkrimit të kontratës, Personat juridik – OJQ duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se Personat juridik - OJQ-të kanë zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me **Udhëzimet për Aplikantët**, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare [www.kk.rks-gov.net/vushtrri/](http://www.kk.rks-gov.net/vushtrri/).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Vushtrrisë

Rr. "Adem Jashari"

(zyra e pranimi, QSHQ ne objektin e komunës )

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

9. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [burim.v.rexhepi@rks-gov.net](mailto:burim.v.rexhepi@rks-gov.net) deri me datën 23.04.2021

Me date 21.04. 2021 (e mërkure) ne ora 11:00, organizohet sesioni informues ne hapësirat e kalasë se qytetit!

#### Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë: inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që mund të kenë ndikim politik, religjioz etj.

Komuna e Vushtrrisë nuk është e detyruar të ndajë të gjithë buxhetin e paraqitur në aplikacion. Buxheti do të ndahet për projektet kualitative të vlerësuara nga komisioni përkatës.

Vushtrri, 16.04.2021

